



MBROJTJA E FËMIJËVE VIKTIMA TË KRIMIT

Roli i Kordinatorit për Mbrojtjen e Viktimave në Prokurori





Zyra e koordinatorit të Subjekteve me Status të Posaçëm



Në çdo Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë ka të emëruar Koordinator të Subjekteve me Status të Posaçëm, i cili informon subjektet mbi të drejtat e tyre gjatë periudhës së çeljes së një çështje penale e deri në përfundim të saj. Çështjet në të cilat përfshihet koordinatori janë: dhuna në familje, abuzim seksual, trafikim i qenieve njerëzore, të miturit në konflikt me ligjin viktimave ose dëshmitar etj.

Detyrat kryesore të koordinatorit të viktimave:

1. Informon dhe njofton subjektet mbi të drejtat e tyre gjatë periudhës së çeljes së një çështje penale e sipas rastit deri në përfundim të saj.
2. Njofton viktimat për mosfillim, pushimin, fillimin dhe përfundimin e një gjykimi.
3. Ndërhyn në emër të viktimës, për të siguruar respektimin e të drejtave të viktimës gjatë procedurës së hetimit, ndjekjes dhe dënimit të një rasti penal.
4. I ndihmon subjektet për të marrë mbrojtje dhe ndihmë nga strukturat shtetërore. Kjo përfshin orientimin e subjekteve drejt shërbimeve shtetërore ose organizatave jofitimprurëse të përshtatshme me nevojat e subjekteve.
5. I këshillon subjektet për të drejtat e tyre, i udhëzon tek autoriteti i duhur për t'i pranuar ato shërbime dhe ndihmon në bashkërendimin e atyre aktiviteteve.
6. Bashkërendon komunikimin ndërmjet prokurorisë dhe subjekteve.
7. Sigurohet që interesat e viktimës të merren në konsideratë gjatë procedurave të hetimit.

Çfarë ndihme jep koordinatori për të miturin viktimë?

Sipas të dhënave statistikore në raportin vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2021, u evidentuan 612 procedime me 657 viktima të mitur, prej të cilëve: 285 vajza dhe 372 djem. Ndërkohë, për vitin 2022, rezulton se numri i procedimeve është 833 me 873 viktima të mitur, nga të cilët: 310 ishin vajza dhe 563 djem, nën moshën 18 vjeç. Të gjithë fëmijët kanë patur mbështetjen e koordinatorëve për viktimat.

Prania e koordinatorit është e domosdoshme tek të miturit viktima në çdo fazë të procedimit penal, si dhe gjatë pyetjes së të miturit mbi ose nën 14 vjeç. Të miturit duhet t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur nga prokurori dhe duhet t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij.

Një i mitur i cili është viktimë e abuzimit seksual, mund të manifestojë disa sjellje: sjellje të përsëritura për vetfajësim, ndryshime në mënyrën e sjelljes në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët në shkollë, vetvlerësim të ulët, mungesë besimi tek të tjerët etj. Këto forma sjellje mund të reflektohen edhe gjatë procesit penal. Ai mund të shfaqë mungesë besimi dhe si pasojë mund të refuzojë të dëshmojë ose të mos përgjigjet duke thënë të vërtetën. Në këtë rast prania e koordinatorit dhe ofrimi i mbështetjes psikologjike gjatë procesit penal e bën të miturin të ndihet më i sigurt.

Koordinatori është një nga personat me anë të të cilëve mund të bëhet njoftimi i të miturit viktimë, në rast konflikti interesi me përfaqësuesin e vet ligjor, ose kur për shkak të moshës shumë të vogël nuk mund të bëhet njoftimi i drejtpërdrejtë i të miturit. Gjithashtu ai i shpjegon në mënyrë të thjeshtë dhe në përshtatje me moshën të drejtat gjatë procesit penal.

Koordinatori është pjesë e grupeve teknike-ndërsektoriale për zgjidhjen e problematikave që lidhen me të miturit. Në këtë mënyrë ai bashkëpunon me sa më shumë struktura të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë dhe të organizatave jofitimprurëse. Pjesëmarrja në këto grupe bëhet me qëllim vlerësimin e nevojave dhe referimin për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes dhe respektimin e interesit më të lartë të fëmijës.



SHËRBIMET PËR FËMIJËT VIKTIMA TË KRIMIT

Ku mund të kërkossh ndihmë?

Më poshtë çdo i mitur, prind, përfaqësues ligjor, ofrues i shërbimeve shoqërore, mësues apo qytetar, mund të gjejë kontaktet kryesore për të raportuar një krim që mund të ketë ndodhur ndaj një fëmijë apo adoleshenti, për të kërkuar ndihmë apo informacion:



Zyra e koordinatorit të Subjekteve me Status të Posaçëm

Prokuroria e Përgjithshme

Tel: 042282000

E-mail: info@pp.gov.al



Zyra e Mbrojtjes Ligjore Falas të Fëmijëve dhe të Rinjve CRCA/ECPAT Shqipëri

Tel: 042265741

Cel: 0675002025

E-mail: fla@crca.al



Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve nga Dhuna Seksuale

Tel: 042265741

Cel: 0675002025

E-mail: barnahus@crca.al



Linja Kombëtare e Telefonit të Ndhmës për Fëmijët në Shqipëri (ALO 116-111)

Tel: 116-111 (24 orë e hapur - falas për fëmijët)

E-mail: alo116@alo116.al

www.alo116.al (në faqe mund të chat me operatorët)



Linja Kombëtare për Internetin e Sigurt për Fëmijët në Shqipëri (iSIGURT.al)

www.isigurt.al (raporto në faqe sipas llojit të incidentit)

E-mail: isigurt@crca.al